


KOSOVO

Analiza gjinore e Ligjit për Buxhetin e vitit 2026



Analiza gjinore e Ligjit për Buxhetin e vitit 2026

Përgatitur nga Elirjeta Beka dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grave të Kosovës

Hyrje

[Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026](#) u miratua nga Qeveria e Kosovës me datë 12 shkurt 2026. Megjithatë, pas këtij miratimi, ky projektligj nuk u vu në dispozicion për konsultime publike në përputhje me [Rregulloren \(QRK\) Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës](#). Si rezultat, vetëm pasi u dërgua në Kuvend qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OShC) patën mundësinë të analizojnë buxhetin dhe të japin rekomandime për të.

[Ligji për barazi gjinore](#) (LBGj) obligon të gjitha institucionet publike të zbatojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGj), i cili përfshinë integrimin gjinor në procesin buxhetor dhe “ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve” për të promovuar barazinë mes grave dhe burrave¹. Integrimi gjinor përkufizohet si përfshirja e perspektivës gjinore në “planifikimin, miratimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit, politikave, programeve dhe buxheteve, në të gjitha fushat politike, ekonomike dhe ato sociale”². BPGj duhet të jetë në përputhje me detyrimet ligjore dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, përkatësisht në përputhje me LBGj-në, [Kornizën Suplementare për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore \(PEFA GRPFM\)](#), dhe [Objektivin 5.c.1 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara \(OZhQ\)](#). Bazuar në një analizë gjinore të këtij ligji, ky komentari synon të japë rekomandime për Qeverinë, Kuvendin dhe komunat lidhur me finalizimin e buxhetit për vitin 2026, si dhe për amandamentet e ardhshme, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 dhe buxhetin për vitin 2027.

Në gusht të vitit 2025, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dërgoi rekomandime për buxhet të [Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve](#) (MFPT), [Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë](#) (MASHT), [Ministria e Drejtësisë](#) (MD), [Ministria e Punëve të Brendshme](#) (MPB), [Këshilli Prokurorial](#), si dhe tek [komunat](#). Ky komentari identifikon dhe trajton **katër çështje thelbësore buxhetore** që kërkojnë vëmendje institucionale për avancimin e barazisë gjinore dhe analizon në çfarë mase këto çështje kyçe, të ndërlidhura me pabarazitë gjinore, janë adresuar në buxhetin për vitin 2026.

Përfshirja e perspektivës gjinore

Pavarësisht kërkesave të PEFA GRPFM dhe treguesin 5.C.1 të OZhQ-ve, ligji për buxhetin e Kosovës nuk përfshin anekse të ndjeshme nga aspekti gjinor dhe nuk përmban deklaratën buxhetore gjinore. Mungesa e një analize të mirëfilltë gjinore dhe e deklaratës buxhetore gjinore e bën të vështirë të vlerësohet mënyra se si buxheti synon të kontribuojë në arritjen e barazisë gjinore. Buxheti për vitin 2026 nuk paraqet ndonjë analizë të nevojave potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave, përfshirë sipas moshës, përkatësisë etnike, aftësisë dhe vendndodhjes gjeografike. Si rrjedhojë, mbetet e vështirë të kuptohet se cilat nevoja specifike synohen të adresohen përmes alokimeve buxhetore dhe në çfarë mase këto alokime do të kontribuojnë në avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore.

Një linjë e rëndësishme buxhetore e lidhur me barazinë gjinore që ka të bëjë me financimin për Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGj), e paraqitur në shumën totale prej 411,722€ në vitin 2026, është rritur për 8% krahasuar me vitin 2025 ku shuma ishte 380,230€. Nuk ka rritje të numrit të punëtorëve. Pozita e një zyrtari për barazi gjinore, nën linjën për paga dhe mëditje në çdo komunë, është e rëndësishme për alokimet e burimeve njerëzore për zbatimin e obligimeve në nivel lokal. Linja buxhetore e emërtuar “Çështjet gjinore” është e përfshirë në buxhetin e vetëm 15 komunave (39%). Kjo linjë specifike buxhetore është rritur (8%) në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, të gjitha komunat e Republikës së Kosovës (38) duhet të alokojnë buxhet për çështje gjinore.

¹ Neni 3, paragrafi. 1.17.

² Neni 3, paragrafi. 1.16.

Adresimi i dhunës me bazë gjinore

Në ligjin për buxhetin e vitit 2026, buxheti për shpenzimet bazike për strehimoret për viktimat e dhunës në familje ka mbetur i njëjtë si në vitin e kaluar (2,500,000€). Buxheti për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave është 611,351€, dhe është rritur për 13% krahasuar me vitin e kaluar. Numri i punonjësve ka mbetur i njëjtë si në vitin 2025, ndërsa projekti për sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve në Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave pritet të përfundojë në vitin 2028 (buxheti total i projektit është 34,460€). Megjithatë, disa shpenzime shtesë të parashikuara nga [Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje](#) (Konventa e Stambollit), të cilën Qeveria është zotuar ta zbatojë, nuk janë të përfshira në projektligjin e buxhetit. Këto përfshijnë:

☛ Nuk është paraparë buxhet për një Qendër të Krizës për Rastet e Përdhunimit për trajtimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale. Propozohet që të ndahen 216,017€ për ndërtimin e Qendrës së Krizës për Rastet e Përdhunimit në vitin 2026, për ngritjen dhe funksionalizimin e saj në vitin 2027, si dhe për funksionimin e rregullt në vitin 2028 dhe në vijim.³

☛ Lidhur me [Projekt- Udhëzimin Administrativ \(QRK\) - Nr. xx/2024 për Linjën Emergjente Telefonike Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore](#) dhe [Protokollin e ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#), në buxhetin e vitit 2026 mbetet e paqartë se në cilën kategori të shpenzimeve janë paraparë linjat telefonike. Kostoja për funksionalizimin e Linjës Telefonike vlerësohet të arrijë rreth 283,800€ në vit për Qeverinë e Kosovës, e llogaritur në bazë të pagës mesatare në sektorin publik dhe privat, çmimeve aktuale të tregut, si dhe normave të parashikuara të inflacionit.

☛ Në bazë të [Protokollit të ri shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale](#) dhe në përputhje me përgjegjësitë institucionale të përcaktuara në [Ligjin nr. 08/1-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore](#), si dhe në [Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave](#), të gjitha komunat duhet të ndajnë buxhet për Qendrat për Punë Sociale (QPS) në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si pjesë e Grantit të Qeverisë për Shërbime Sociale, për të punësuar dy punonjës socialë shtesë të ngarkuar në mënyrë specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Këto pozita janë thelbësore për zbatimin e kornizës së re ligjore, parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e të mbijetuarave, kryesisht grave dhe fëmijëve. Megjithatë, në ligjin për buxhet për vitin 2026, ky obligim nuk është zbatuar. Kostoja shtesë për punësimin e dy punonjësve socialë në secilën komunë për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje, do të arrinte rreth 702,000€ në vit për Qeverinë e Kosovës⁴. Konkretisht, kjo do të arrinte 18,000€ për komunë për 37 komuna (666,000€) dhe 36,000€ për Prishtinën.

☛ Buxheti për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është rritur për 13% krahasuar me vitin e kaluar, por nuk ka pasur rritje të burimeve njerëzore. Bazuar në [rekomandimet e RrGK-së](#), duhet të alokohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe të sigurohet financim për përmirësimin e infrastrukturës, në mënyrë që gratë që kërkojnë ndihmë juridike, veçanërisht ato që kujdesen për fëmijë, të kenë qasje në shërbime në kushte të sigurta, me privatësi dhe dinjitet gjatë gjithë procedurave ligjore.

☛ Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të sigurojë që buxheti për burimet njerëzore të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave të garantojë staf të mjaftueshëm, kompensim të drejtë dhe trajnim të vazhdueshëm profesional, në mënyrë që të ofrohet mbështetje efektive për viktimat dhe të promovohet barazia gjinore. Edhe pse buxheti për vitin 2026 (611,351€) është rritur për 13% krahasuar me vitin 2025 (542,146€), numri i stafit ka mbetur i njëjtë. Aktualisht, numri i mbrojtësve të viktimave

³ RrGK, *Me çfarë çmimi? Vlerësimi i kostos së shërbimeve të specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë*, pritet të publikohet, 2026.

⁴ Përlllogaritja e RrGK-së: Bazuar në Buxhetin 2026, Departamenti i Shërbimeve Sociale në të gjitha komunat (460 punonjës) ka një alokim total vjetor prej 4,140,819 €, që përkthehet në rreth 9,001.78 € për punonjës në vit (≈ 750 € në muaj); 37 komuna × 2 punonjës = 74; 74 × 750 € × 12 muaj = 666,000€; Prishtina 4 × 750 € × 12 muaj = 36,000 €; Totali vjetor = 702,000 €.

është i pamjaftueshëm për të përmbushur përgjegjësitë ligjore dhe për të garantuar mbrojtje adekuate për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet të forcojë mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe të parandalojë përsëritjen e rasteve të tilla duke ndarë fonde të mjaftueshme për blerjen, funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të monitorimit, përfshirë byzylykët elektronikë. Këto sisteme janë thelbësore për monitorimin efektiv të autorëve të dhunës dhe për të garantuar respektimin e urdhrave të mbrojtjes, duke ofruar një mekanizëm shtesë sigurie dhe reagim më të shpejtë institucional për të mbijetuarat.

Financimi adekuat i Skemës së Asistencës Personale

Buxheti i vitit 2026 nuk merr parasysh [pagën minimale dhe kohën aktuale që kërkohet nga asistentët personalë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara](#). Kjo kontribuon në shkeljen e të drejtave të tyre të punës. Ekziston nevoja për të rritur buxhetin e alokuar për asistentët personalë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë (PTTP), i cili aktualisht është 150€, si dhe për personat e verbër, për të cilët shuma aktuale është 125€, në mënyrë që të përputhet së paku me pagën minimale (425€ bruto) ose, në mënyrë ideale, me pagën mesatare (639€ bruto). Asistentët personalë shpesh punojnë më shumë se tetë orë në ditë për të ofruar kujdes dhe nuk u paguhet kontributi për pension. Kjo përbën shkelje të të drejtave të tyre të punës sipas Ligjit të Punës. Gratë prirën të jenë të mbipërfaqësuar në mesin e asistentëve personalë dhe adresimi i këtyre çështjeve mund të përmirësojë jo vetëm jetesën e tyre, por edhe të personave për të cilët ata kujdesen. Duke marrë parasysh që në vitin [2025, kishte 34,823,021 persona PTTP dhe 187,749 persona të verbër](#), rritja e pagës do të kushtonte rreth 25.6€ milionë për vitin 2026 bazuar në pagën minimale, që është afërsisht dyfishi i shpenzimeve aktuale. Buxhetimi i bazuar në pagën mesatare bruto do të kushtonte përafërsisht 38.4 milionë €.⁵

Financimi adekuat i shërbimeve të kujdesit

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet të investojë drejtpërdrejt dhe të inkurajojë komunat të planifikojnë buxhet më të mirë për krijimin e më shumë qendrave publike dhe kopshteve për kujdesin e fëmijëve. Duke [vendosur objektiva konkrete dhe alokime buxhetore bazuar në vlerësime të gjithanshme të nevojave, komunat mund të adresojnë nivelet e larta të papunësisë dhe pasivitetit](#). RrGK ka vlerësuar se zgjerimi i opsioneve të kujdesit ndaj fëmijëve mund të krijojë [afërsisht 9,899 vende të reja pune](#) në këtë fushë, duke transformuar kështu punën e papaguar të kujdesit në punë të paguar. Për më tepër, kjo do t'i mundësojë më shumë grave të punojnë dhe do të përmirësojë rezultatet arsimore në përputhje me [Objektivat e Barcelonës të BE-së](#). Planifikimi i buxhetit për rritjen e disponueshmërisë së [shërbimeve të përballeshme të kujdesit, veçanërisht në zonat rurale, është thelbësor për transformimin e punës së kujdesit së papaguar në punë të paguar, angazhimin e më shumë grave në tregun e punës dhe mbështetjen e një edukimi të përgjegjshëm gjinor që nga mosha e hershme](#). Nevojiten alokime më të mëdha buxhetore për të përmbushur zotimet e përcaktuara në [Strategjinë Kombëtare për Zhvillim](#), sipas ligjit për buxhetin e vitit 2026 janë alokuar total 21 milionë € për arsim parashkollor në 35 komuna (92%), numri i punonjësve është 1,955 dhe investimi kapital për arsim parashkollor është 1.8 milionë €. Ndërsa buxheti për vitin 2026 për Komunën e Zubin Potok mungon. Qeveria ka një detyrim ligjor për të realizuar këto investime, për të cilat tani duhen bërë alokimet buxhetore. I bëjmë thirrje komunave dhe MASHTI-t të alokojnë më shumë fonde të tilla dhe të inkurajojë fuqimisht komunat që të bëjnë të njëjtën gjë. Shpresojmë në uljen e varësisë nga financimet e jashtme për të siguruar burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme buxhetore për të ardhmen, për këtë prioritet të rëndësishëm të zhvillimit kombëtar.

Shqetësime të tjera

Dispozita që përcakton se “Pas aprovimit të rregullores së re për organizimin e brendshëm të Qeverisë, me vendim të Qeverisë, autorizohet Ministri që të bëjë përshtatjet e nevojshme të ndarjeve buxhetore dhe kodeve tjera përkatëse në sistemet buxhetore⁶”, ngre shqetësime për mbikëqyrjen

⁵ Bazuar në përllogaritjen e RrGK-së.

⁶ Neni 11, paragrafi 5.

demokratike, transparencën dhe llogaridhënien. Në një sistem parlamentar, kompetenca për të miratuar dhe ndryshuar ndarjet buxhetore i takon Kuvendit, si organi më i lartë përfaqësues i qytetarëve. Lejimi që këto ndryshime të bëhen nga ekzekutivi pa shqyrtim parlamentar dobëson ndarjen e pushteteve dhe kufizon mekanizmat e kontrollit. Kjo është veçanërisht shqetësuese për OShC dhe qytetarët, pasi zvogëlon mundësitë për shqyrtim publik, konsultim dhe pjesëmarrje. Çdo modifikim i ndarjeve buxhetore duhet të ndjekë procedurat parlamentare për të garantuar ligjshmëri, transparencë dhe kontroll demokratik.

Dispozita që përcakton se “Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkalojë numrin e të punësuarve [...] përveç lehonave dhe mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore [...] Çdo tejkallim [...] konsiderohet shkelje ligjore [...]” vendos një kufi të prerë për numrin e të punësuarve, me disa përjashtime, pa marrë parasysh nevojat reale të shërbimeve publike dhe obligimet ligjore të institucioneve. Kjo qasje nuk është neutrale nga perspektiva gjinore, pasi kufizon fleksibilitetin në sektorët ku gratë përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore dhe ku kërkesa për shërbime është në rritje (si shëndetësia, kujdesi, shërbimet sociale dhe arsimi parashkollor), duke rritur ngarkesën e punës, ulur cilësinë e shërbimeve dhe vështirësuar zbatimin e politikave për barazi gjinore dhe mbrojtje sociale.

Paragrafi i dytë thotë “[N]umri i të punësuarve dhe shuma për paga dhe shtesa nëpër nën-programe [...] mund të përshtaten me aprovim të Ministrit [...] për OB-të lokale nevojitet edhe vendimi i Kuvendit Komunal [...]”. Kjo lejon që përshtatja e numrit të të punësuarve dhe e mjeteve për paga dhe shtesa të bëhet me aprovim të Ministrit, pa kaluar në procedurë parlamentare dhe pa miratim nga Kuvendi i Kosovës, edhe pse këto ndryshime prekin një element thelbësor të buxhetit të miratuar. Kjo zhvendos vendimmarrjen nga niveli legjislativ në atë ekzekutiv, dobëson transparencën dhe llogaridhënien buxhetore dhe cenon autoritetin buxhetor të Kuvendit.

Paragrafi i tretë thotë “[N]ë rastin e riorganizimit [...] numri i të punësuarve [...] mund të përshtatet me vendim të Ministrit [...] me kusht që numri total [...] të mos tejkalohet [...]”. Kjo dispozitë i jep kompetencë Ministrit për të ndryshuar numrin e stafit pas riorganizimit të Qeverisë pa miratim parlamentar. Megjithatë një nivel fleksibiliteti është i nevojshëm gjatë ristrukturimit, kjo zhvendos kompetencën buxhetore nga legjislativi te ekzekutivi. Në situatën aktuale, kur disa ministri nuk kanë linja të miratuara buxhetore, kjo krijon pasiguri ligjore dhe operacionale për planifikimin e stafit dhe funksionimin institucional.

Paragrafi i katërt thotë “autorizohet Qeveria [...] të vendosë për përshtatjen e numrit të lejuar të të punësuarve [...] sipas numrit real [...] në rast të ndryshimit të strukturës së Qeverisë.” Ky paragraf i jep Qeverisë kompetencën të ndryshojë numrin e përgjithshëm të të punësuarve sipas situatës faktike në momentin e miratimit të buxhetit, në rast ristrukturimi, pa iu kthyer procedurës parlamentare, duke ngritur shqetësime për transparencën dhe llogaridhënien.

Meqenëse ndikojnë në proceset demokratike, të gjitha këto dispozita mund të kenë një ndikim të dyfishtë në angazhimin e grave në proceset vendimmarrëse përmes parlamentit dhe konsultimeve publike, duke përfshirë edhe organizatat për të drejtat e grave. Kjo mund të pengojë angazhimin e ekspertizës së ekspertëve për çështjet gjinore në konsultimin mbi ndryshimet buxhetore.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka [konstatuar se Projektligji për ndarjet buxhetore për vitin 2026 është antikushetues](#), pasi nuk zbaton aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO79/23 për kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë. Në vend që kjo e drejtë të zbatohet nga 1 shkurti 2024 dhe përmes ndryshimit të Ligjit për pagat në sektorin publik, projektligji e shtyn zbatimin për vitin 2026 dhe tenton ta rregullojë atë përmes një ligji vjetor, pa respektuar afatin dhe standardin e kërkuar kushtetues. Sipas IKD-së, kjo përbën moszbatim të një aktgjykimi me fuqi të barabartë me normën kushtetuese, cenon të drejtat e mbi 90,000 zyrtarëve publikë dhe krijon pasoja financiare për ta. Nga perspektiva gjinore, kjo çështje ka rëndësi të veçantë, pasi gratë janë të mbipërfaqësuara në nivelet e caktuara të administratës publike dhe shpesh kanë ndërprerje të karrierës për shkak të kujdesit ndaj familjes. Shtyrja e kompensimit të përvojës së punës rrit pabarazitë gjinore në paga dhe mund të ndikojë negativisht në progresin e grave në administratën publike, duke përforcuar hendekun gjinor dhe cenuar barazinë në punësim dhe pagë.

Rekomandimet

Për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës rekomandohet që, gjatë rishikimit buxhetor të muajit mars, si dhe në procesin e hartimit të KASH-it dhe buxheteve të ardhshme, të sigurohet që linjat

përkatëse buxhetore të ministrive dhe komunave të kenë ndarje të qarta dhe të mjaftueshme buxhetore për:

☛ **Përmirësimin e barazisë gjinore** Të sigurohet që çdo komunë të ketë buxhet për paga dhe mëditje për zyrtaren/in për barazi gjinore, në mënyrë që ky person të mund të zbatojë detyrimet e tij/saj ligjore.

☛ **Adresimin e dhunës me bazë gjinore:**

☛ Ministria e Drejtësisë duhet të alokojë 216,017€ për një Qendër të Krizës për Rastet e Përdhunimit, për të ofruar trajtim për të mbijetuarat e dhunës seksuale, dhe 283,800€ për funksionimin e një linje telefonike SOS, në përputhje me Konventën e Stambollit.

☛ Buxheti i alokuar për QPS në kategorinë e pagave dhe mëditjeve duhet të rritet për të punësuar dy punonjës socialë shtesë në secilën komunë, dhe katër në Prishtinë, të ngarkuar në mënyrë specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Kostoja shtesë është rreth 702,000€

☛ Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përmirësojë mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe të parandalojë përsëritjen e rasteve të tilla, duke ndarë fonde për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të monitorimit.

☛ **Skemën e Asistencës Personale:** Të rritet linja buxhetore për financimin e Skemës së Asistencës Personale në përputhje me kohën reale të punës që kërkohet nga asistentët personalë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara, dhe për të adresuar shkeljet e të drejtave të punës së tyre. Bazuar në pagën minimale, kjo do të kushtonte rreth 25,6 milionë € për vitin 2026, ndërsa buxheti i bazuar në pagën mesatare bruto do të kushtonte përafërsisht 38,4 milionë €.

☛ **Financimin adekuat të shërbimeve të kujdesit:** MASHTI dhe komunat duhet të financojnë krijimin e qendrave të kujdesit për fëmijë me qëllim të rritjes së punësimit të grave dhe përmirësimin të rezultateve në arsim.

☛ Qeveria duhet të publikojë Deklaratën Buxhetore Gjinore në përputhje me zotimet e PEFA dhe treguesin 5.c.1. të OZhQ-ve, duke treguar se si buxheti do të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore në Kosovë në përputhje me zotimet e Qeverisë.

☛ Qeveria duhet të publikojë online të gjitha anekset buxhetore gjinore të dorëzuara nga organizatat buxhetore, në përputhje me kërkesat e qarkoreve buxhetore, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Shtojca 1. Buxhetet e komunave për barazi gjinore (Linjat buxhetore për çështje gjinore)

Tabela më poshtë tregon, për secilën komunë, buxhetin e alokuar për çështjet gjinore në vitin 2025 krahasuar me vitin 2026, duke reflektuar ndryshimin në vlerë absolute dhe në përqindje, si dhe ndryshimet në numrin e punonjësve të angazhuar për këto çështje.

Komuna	Buxheti për çështjet gjinore 2025 (euro)	Buxheti për çështjet gjinore 2026 (euro)	Dallimi (euro)	%	Numri i punonjësve 2025	Numri i punonjësve 2026
Deçan						
Dragash	10,808	12,730	1,922	18%	1	1
Ferizaj						
Fushë Kosovë	28,032	34,733	6,701	24%	2	2
Gjakovë						
Gjilan						
Drenas						
Graçanicë	12,142	13,690	1,548	13%	1	1
Han i Elezit						
Istog	30,641	36,726	6,085	20%	3	3
Junik						
Kaçanik	16,269	17,189	920	6%	1	1
Kamenicë	14,722	0	-14,722	-100%	1	0
Klinë	13,893	14,524	631	5%	1	1
Kllokot						
Leposaviq						
Lipjan						
Malishevë	21,417	24,188	2,771	13%	1	1
Mamushë						
Mitrovicë e Veriut						
Mitrovicë	46,500	48,094	1,594	3%	2	2
Novobërdë	13,339	13,659	320	2%	1	1
Obiliq						
Partesh	9,000	8,250	-750	-8%	1	1
Pejë	27,482	41,477	13,995	51%	1	2
Podujevë						
Prishtinë						
Prizren						
Rahovec	9,200	11,172	1,972	21%	1	1
Ranillug	10,970	12,230	1,260	11%	1	1
Shtërpcë						
Shtime						
Skenderaj	36,400	38,500	2,100	6%	3	3
Suharekë						
Viti						
Vushtrri	18,338	16,662	-1,676	-9%	3	3
Zubin Potok						
Zveçan						
Gjithsej	319,153	343,824 €	24,671	8%	24	23

Shtojca 2. Ndarjet buxhetore për arsim parashkollor sipas komunave

Tabela më poshtë tregon, për secilën komunë, buxhetin e alokuar për arsimin parashkollor në vitin 2025 krahasuar me vitin 2026, numrin e punonjësve për të njëjtën periudhë, si dhe investimet kapitale për vitin 2026.

Komuna	Numri i punonjësve 2025	Ndarja buxhetore 2025 (euro)	Numri i punonjësve 2026	Ndarja buxhetore 2026 (euro)	Investimet kapitale 2026 (euro)
Drenas	30	270,141	42	398,855	
Fushë Kosovë	49	795,635	49	1,038,98	480,000
Lipjan	74	774,680	75	1,074,89	210,000
Obiliq	15	137,976	33	344,360	
Podujevë	63	818,972	75	1,101,924	300,000
Prishtinë	280	3,455,000	280	3,573,373	400,000
Shtime	49	441,209	57	566,409	
Graçanicë	44	306,643	44	338,093 €	
Dragash	36	226,000	42	446,439 €	
Prizren	65	1,246,516		1,115,357	400,000
Rahovec	34	357,500	34	384,250	
Suharekë	45	360,674	45	405,000	
Malishevë	112	1,002,791	117	1,263,653	
Mamushë	4	24,913	5	38,043	
Gjakovë	120	1,160,000	135	1,344,000	
Istog	49	465,212	54	515,862	10,000
Klinë	20	186,130	20	199,374	
Pejë	99	908,191	105	1,069,147	
Junik	0	0	11	84,811	
Leposaviq	82	462,964	82	472,000	
Mitrovicë	62	540,000	59	732,854	
Skenderaj	49	483,800	55	535,472	
Vushtrri	68	661,052	69	730,822	10,000
Zubin Potok	24	97,500	Mungon Buxheti për vitin 2026		
Zveçan	30	35,600	30	50,300	
Mitrovicë e Veriut	39	200,000	39	-196,500	
Gjilan	147	1,517,696	170	1,737,600	
Kaçanik	21	225,005	27	253,175	
Kamenicë	46	335,610	51	406,362	
Novobërdë	13	89,232	13	107,416	
Ferizaj	46	459,491	58	576,753	
Viti	34	294,496	34	328,445	
Partesh	6	52,000	7	74,000	
Han i Elezit	13	115,536	13	133,147	
Kllokot	9	73,271	9	75,271	
Ranillug	16	133,296	16	160,760	
Gjithsej	1,893	18,714,732	1955	21,480,699	1,810,000

Shtojca 3. Ndarjet buxhetore për shërbime sociale

Tabela më poshtë tregon, për secilën komunë, buxhetin e alokuar për paga dhe mëditje për shërbime sociale në vitin 2025 krahasuar me vitin 2026, numrin e punonjësve për të njëjtën periudhë, si dhe ndryshimet në paga, mëditje dhe numrin e punonjësve. Kjo ilustron se burimet njerëzore të parashikuara nga protokollin e ri shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale nuk janë alokuar, në përputhje me përgjegjësitë institucionale të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, si dhe në Strategjinë kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave.

Komuna	Numri i punonjësve 2025	Paga dhe mëditje 2025	Numri i punonjësve 2026	Paga dhe mëditje 2026	Dallimi Numri i punonjësve	%	Dallimi Paga dhe mëditje 2026	%
Deçan	10	85,217	10	95,652	0	0%	10,435	12%
Drenas	14	116,422	14	139,122	0	0%	22,700	19%
Gjakovë	18	111,339	18	186,261	0	0%	74,922	67%
Gjilan	16	111,451	16	143,220	0	0%	31,769	29%
Dragash	10	70,000	10	87,925	0	0%	17,925	26%
Istog	12	92,893	12	108,923	0	0%	16,030	17%
Kaçanik	8	61,120	8	74,658	0	0%	13,538	22%
Klinë	11	90,104	11	103,409	0	0%	13,30	15%
Fushë Kosovë	10	75,746	10	89,724	0	0%	13,978	18%
Kamenicë	13	97,354	12	114,952	-1	-8%	17,598 €	18%
Leposaviq	10	46,670	10	56,235	0	0%	9,565	20%
Lipjan	13	105,874	13	112,793	0	0%	6,919	7%
Obiliq	11	84,465	10	95,027	-1	-9%	10,562	13%
Rahovec	15	108,000	15	136,000	0	0%	28,000	26%
Pejë	20	154,801	21	187,901	1	5%	33,100	21%
Podujevë	13	106,267	14	138,724	1	8%	32,457	31%
Prishtinë	47	360,000	47	413,627	0	0%	53,627	15%
Prizren	26	199,323	26	261,469	0	0%	62,146	31%
Skenderaj	17	118,300	17	170,000	0	0%	51,700	44%
Shtime	10	74,000	10	86,000	0	0%	12,000	16%
Shtërpçë	8	64,977	8	78,112	0	0%	13,135	20%
Suharekë	13	101,000	12	113,000	-1	-8%	12,000	12%
Ferizaj	17	125,821	17	132,051	0	0%	6,230	5%
Viti	15	120,000	15	131,055	0	0%	11,055	9%
Vushtri	13	92,300	13	111,228	0	0%	18,928	21%
Zubin Potok	13	76,006	13	76,006	0	0%	0	0%
Zveçan	12	65,377	12	86,400	0	0%	21,023	32%
Malishevë	9	81,591	9	92,407	0	0%	10,816	13%
Novobërdë	4	31,330	4	38,452	0	0%	7,122	23%
Mitrovicë e Veriut	12	85,000	12	101,000	0	0%	16,000	19%
Mitrovicë e Jugut	28	191,000	24	232,378	-4	-14%	41,378	22%
Junik	2	13,089	3	20,194	1	50%	7,105	54%
Han i Elezit	3	24,585	3	28,200	0	0%	3,615	15%
Mamushë	2	16,203	2	18,184	0	0%	1,981	12%
Graçanicë	4	28,989	5	43,425	1	25%	14,436	50%
Ranillug	4	30,838	4	37,105	0	0%	6,267	20%
Partesh								
Kllokot								
Gjithsej	463	3,417,452	460	4,140,819	-3	-0.6%	723,367	21%